

Ndikimi i

# industrive kreative

në zhvillimin ekonomik të Komunave Perëndimore të Kosovës

CH  
WB  
Cultural  
Heritage without Borders  
KOSOVO







Ky botim është financuar nga Qeveria e Suedisë përmes Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA). Përmbajtja e këtij materiali nuk mund të merret parasysh për të pasqyruar pikëpamjet e SIDA-s.



### **Maj 2019**

Redaktorë: Adea Mekuli,

Erinë Mulolli Zajmi

Hulumtues: Donikë Limani, Kujtim Koci,


Lorëz Qehaja

Botimi: Fondacioni Kosovar

Trashëgimia Kulturore Pa Kufij

(CHWB Kosova)

Dizajni: Trembelat



Ndikimi i

# industrive kreative

në zhvillimin ekonomik të Komunave Perëndimore të Kosovës

## **Tabela e përmbajtjes**

Përmbledhje Ekzekutive —11

1. Hyrje —15

1. Metodologjia —17

1.1. Hartimi i mostrës të bizneseve —17

2. Të gjeturat e studimit —21

2.1. Ndikimi ekonomik i bizneseve të industrive kreative në regjionin e Dukagjinit —22

2.1.1. Të dhënat e ndara sipas aktivitetit të biznesit në industritë kreative —28

2.1.2. Pjesëmarrja në evente kulturore —31

2.2. Roli i OJQ-ve në industritë kreative në regjionin e Dukagjinit —34

2.2.1. Analizë krahasuese në mes të OJQ-ve dhe bizneseve në industritë kreative —38

2.3. Roli i Komunave në industritë kreative në regjionin e Dukagjinit —41

3. Përfundime —49

## **Aneksi —55**

Pyetësorët e përdorur për anketa —55

Pyetësori për biznese —56

Pyetësori për OJQ —59

Pyetësori për komuna —63

## Lista e figurave

**Figura 1:** Mediana e të hyrave të bizneseve në industritë kreative sipas komunës 2015, 2016 dhe 2017 —23

**Figura 2:** A prisni të keni të hyra më të larta apo më të ulëta në vitin 2019 në krahasim me këtë vit (2018)? Burimi: Anketa me Bizneset në Industritë Kreative —25

**Figura 3:** Krahasimi i pagave në mes të aktiviteteve dhe orarit të punëtorëve —29

**Figura 4:** A jeni kontraktuar ndonjëherë nga komuna për organizim apo pjesëmarrje në evente kulturore në komunën tuaj? —31

**Figura 5:** Cili ka qene roli juaj në këto evente kulturore? (Përgjigje e shumëfishtë) —32

**Figura 6:** A keni punësuar njerëz të tjerë enkas (jo pjesë e stafit) për këto evente kulturore? —32

**Figura 7:** Sipas mendimit tuaj sa janë të rëndësishme eventet kulturore për aspektet e mëposhtme? —33

**Figura 8:** Sipas mendimit tuaj, kush janë përfituesit kryesorë të këtyre eventeve —33

**Figura 9:** Ju lutem na tregoni sa persona keni punësuar në OJQ-në tuaj gjatë vitit 2017 dhe 2018? —34

**Figura 10:** Paga mesatare mujore —35

**Figura 11:** A keni organizuar ose marrë pjesë ndonjëherë në evente kulturore në komunën tuaj? —35

**Figura 12:** Cili ka qenë roli juaj në këto evente kulturore? —36

**Figura 13:** A keni punësuar punëtorë të tjerë enkas për këto evente kulturore? —36

**Figura 14:** Sipas mendimit tuaj sa janë të rëndësishme eventet kulturore për aspektet e mëposhtme? —37

**Figura 15:** Sipas mendimit tuaj, kush janë përfituesit kryesorë të këtyre eventeve? —37

**Figura 16:** Krahasimi i pagave mesatare të punëtorëve në industritë kreative në mes të OJQ-ve dhe bizneseve —38

**Figura 17:** Rolet e OJQ-ve dhe bizneseve në evente kulturore —39

**Figura 18:** Krahasimi në mes OJQ-ve dhe bizneseve: Sipas mendimit tuaj sa janë të rëndësishme eventet kulturore për aspektet e mëposhtme? [1 = aspak të rëndësishme; 7 = shumë të rëndësishme] —40

**Figura 19:** Krahasimi në mes të OJQ-ve dhe bizneseve: Sipas mendimit tuaj, kush janë përfituesit kryesorë të këtyre eventeve? —40

**Figura 20:** Ju lutem na tregoni sa punëtorë janë të punësuar në departamentin e kulturës, rinisë dhe sportit? —41



**Figura 21:** Sipas mendimit tuaj sa janë të rëndësishme eventet kulturore për aspektet e mëposhtme? (Ne shcallë nga 1 deri në 7, ku 1 nënkupton shumë e rëndësishme dhe 7 aspak e rëndësishme, 888 Nuk e di dhe 999 Refuzoj) —42

**Figura 22:** Sa evente kulturore ka organizuar ose ka marrë pjesë komuna? —43

**Figura 23:** Sa vizitorë kanë vizituar komunën në vitin 2017 gjatë këtyre eventeve kulturore? Numri i vizitorëve në evente për vitin 2018 sipas parashikimeve të komunave. (A prisni që numri i vizitorëve për vitin e ardhshëm?) —44

## Lista e tabelave

**Tabela 1:** Shpërndarja e mostrës sipas komunave —18

**Tabela 2:** Mediana e të hyrave të bizneseve në industritë kreative sipas komunës 2015, 2016 dhe 2017. Burimi: Anketa me Bizneset në Industritë Kreative —23

**Tabela 3:** Mediana e të hyrave të bizneseve në industrive kreative 2017 e ndarë për komunë —24

**Tabela 4:** Tatimet mesatare të paguara nga bizneset e industrive kreative në vitin 2017 e ndarë për komunë —25

**Tabela 5:** Të punësuarit në industritë kreative krahasuar me numrin total të të punësuarve për komunë —26


**Tabela 6:** Paga mesatare për komuna në industritë kreative. Burimi: Anketa me Bizneset në Industritë Kreative —27

**Tabela 7:** Paga mesatare për regjion —27

**Tabela 8:** Tabela përmbledhëse me të dhëna të punësimit sipas aktivitetit të bizneseve. Burimi: Anketa me Bizneset në Industritë Kreative —29

**Tabela 9:** Numri i të punësuarve në industritë kreative —30

**Tabela 10:** Numri i vizitorëve në regjionin e Pejës dhe Gjakovës (2017-2018) —45



përmbledhje  
ekzekutive

**Raporti është i hartuar** në vazhdimësi të Studimit për Sistemin Kulturor Territorial (SKT) për Kosovën Perëndimore<sup>1</sup>, i iniciuar nga CHwB Kosova dhe i kryer në bashkëpunim me Institutin Kërkimor SEMEION, Universitetin IULM dhe Uppsala.

Gjatë projektit disa vjeçar për Sistemin Kulturor Territorial janë shenjuar asetet dhe aktivitetet në kulturë dhe sport në këto gjashtë (6) komuna: Deçan, Gjakovë, Istog, Junik, Klinë, Pejë.

Industritë kreative janë ato industri që kanë origjinën e tyre në krijimtarinë, aftësitë dhe talentin individual dhe që kanë potencial për zhvillim ekonomik dhe krijim të vendeve të punës përmes gjenerimit dhe shfrytëzimit të pronës intelektuale.<sup>2</sup> Edhe pse vazhdon debati rreth përcaktimit të saktë të industrive kreative, ka një pajtim të përgjithshëm për disa kategori, siç janë: Media dhe Marketing, Arkitekturë, Artizanate, Dizajn, Dizajn i Modës, TV, Radio dhe Fotografi, Teknologji të Informacionit, Publikime, Museume, Galeri dhe Biblioteka, Muzikë, Arte Performuese dhe Arte Vizuele, Gastronomi, e të tjerë.

Në komunat perëndimore të Kosovës të cilat janë pjesë e këtij studimi, industritë më të pranishme që bijnë nën industritë kreative janë identifikuar si: Aktivitetet Sportive (të natyrës); Dizajni i Modës; Eventet Kulturore; Gastronomia; Radio & TV; Vallëzim dhe Produksion tjetër.

Raporti ka për qëllim të matë kontributin e këtyre industrive kreative në zhvillimin ekonomik rajonal në gjashtë komunat e Kosovës Perëndimore. Raporti fokusohet në kontributin e bizneseve që operojnë në industritë kreative në këto komuna, duke analizuar gjithashtu përkrahjen e komunës dhe kontributin e organizatave joqeveritare që ofrojnë aktivitete për këtë sektor. Më specifikisht, objektivat e këtij

Raporti fokusohet në kontributin e bizneseve që operojnë në industritë kreative në këto komuna, duke analizuar gjithashtu përkrahjen e komunës dhe kontributin e organizatave joqeveritare.

---

1 Burimi: Buscema, M., Ferilli, G. and Sacco, P.L. (2017) *The geographical computational profiling of the West part of Kosovo (Profilizimi i Pjesës Perëndimore të Kosovës përmes procesimit të të dhënave gjeografike)*.

2 Burimi: DCMS (2001), Creative Industries Mapping Document 2001 (2 ed.), London, UK: Department of Culture, Media and Sport (*Dokumenti i Shenjimit të Industrive Kreative 2001*, edicioni i 2-të, Londër, BM, Departamenti për Kulturë, Media dhe Sport)

studimi janë të krahasojë të hyrat e bizneseve të këtij sektori me të hyrat e të gjitha bizneseve që operojnë në këto komuna, të ofrojë informata mbi numrin e të punësuarve dhe pagën mesatare të kësaj industrie, të analizojë të dhënat në bazë të aktiviteteve të bizneseve pjesëmarrëse në studim dhe kontributin e këtij sektori në zhvillimin kulturor të këtyre komunave.

Metodologjia kuantitative është përdorur për realizimin e këtij hulumtimi. Anketë gjysmë e strukturuar është përdorur për intervistimin e 314 bizneseve, 36 OJQ-ve dhe zyrtarëve komunal në këto gjashtë komuna.

**Vërejtje:** Bizneset e intervistuar janë përzgjedhur nga lista e bizneseve që operojnë në këto gjashtë komuna e marr nga Agjencia për Regjistrim të Bizneseve të Kosovës (ARBK). Në disa raste është vërejtur që lista përmban biznese jo-aktive dhe biznese që janë të regjistruara si veprimtari të ndryshme nga veprimtaria që operojnë. Sidoqoftë, hulumtimi është i bazuar vetëm në statistika zyrtare, në këtë rast në listat e ARBK-së dhe ATK-së. CHwB Kosova nuk mban përgjegjësi për përmbajtjen e listave.

Ky hulumtim ka arritur në këto përfundime:

↑  
11%

—**Të hyrat mesatare** sipas medianës të bizneseve në industritë kreative në regjionin e Dukagjinit për vitin 2017 janë 41,947.66 EUR. Të hyrat e bizneseve janë rritur për 11% nga viti 2015 në vitin 2016, dhe për 4% nga viti 2016 në vitin 2017.

PEJA  
33.2%

—**Industritë kreative** kanë pjesëmarrjen më të lartë në ekonominë e Pejës (33.2%) kur i marrim parasysh të hyrat e

përgjithshme të sektorit privat në secilën prej gjashtë komunave.

—**Në përgjithësi bizneset** presin rritje të të hyrave për vitin 2018 dhe 2019.

—**Gjatë vitit 2017** bizneset kanë punësuar 3 punëtorë të rregullt me orar të plotë.

—**Nga 314 biznese** të intervistuar, 6 prej tyre kanë deklaruar se kanë punësuar mesatarisht 4 punëtorë me

gjysmë orari gjatë vitit 2017, kurse 36 prej tyre kanë deklaruar se kanë punësuar mesatarisht 5 punëtorë sezonal.

—**Paga mesatare** e punëtorëve të rregullt me orar të plotë në industritë kreative në këto komuna është €277, e që është më e ultë se rroga mesatare në Kosovë (€528).

—**33 (11%) nga bizneset** e intervistuar janë kontraktuar nga komuna për organizim apo pjesëmarrje në evente kulturore, dhe 10 nga to kanë deklaruar se kanë punësuar mesatarisht 4 persona enkas për këto evente.

—**Numri mesatar i punëtorëve** me orar të plotë që janë të përfshirë në projekte brenda industrive kreative në OJQ është 1.5, që përbën 5 përqind të të gjithë punëtorëve me orar të plotë.

—**Paga mesatare mujore** (bruto) e të punësuarve të përfshirë në projekte brenda industrive kreative është raportuar të jetë €328.


—**86% e OJQ-ve** janë kontraktuar nga komuna për organizim apo pjesëmarrje në evente kulturore, dhe 56% e tyre kanë deklaruar se kanë

punësuar persona enkas për këto evente.

—**Të gjitha komunat** ndajnë mendimin se eventet kulturore janë shumë të rëndësishme për turizëm si dhe për promovimin e kulturës për të njëjtin qëllim.

—**Komuna e Pejës** ka numrin më të lartë të pjesëmarrësve për eventet kulturore, ndërsa ajo e Klinës ka numrin më të ultë të pjesëmarrësve për këto raste. Regjioni i Pejës është regjioni i dytë më i vizituar në Kosovës pas regjionit të Prishtinës. Regjioni i Gjakovës është dukshëm më mbrapa regjionit të Pejës për sa i përket numrit të vizitorëve të jashtëm dhe vendorë si për vitin 2017 dhe për 2018.

—**Komuna e Klinës dhe Istogut** nuk kanë qendra për informata turistike. Komuna e Pejës dhe Deçanit kanë nga një qendër që punësojnë 3 dhe 2 persona, respektivisht. Komuna e Junikut dhe ajo e Gjakovës kanë nga dy qendra për informata turistike, të cilat punësojnë gjithsej 8 persona (6 dhe 2 respektivisht).



## Hyrje

Ky raport ka për qëllim prezantimin e të dhënave të mbledhura në lidhje me kulturën dhe trashëgiminë kulturore për zhvillim rajonal në gjashtë komunat Kosovës Perëndimore (Deçan, Gjakovë, Istog, Junik, Klinë dhe Pejë). Një ndër qëllimet e këtij projekti është krijimi i një platforme bashkëpunimi ndërmjet komunave të lartpërmendura. Përmes këtij bashkëpunimi dhe aktiviteteve të ndryshme, pritet që të përmbushet një tjetër objektivi kyç i këtij projekti – rritja e dinamikës dhe diversitetit kulturor (“cultural vibrancy”) në rajon dhe rritja e bashkëpunimit me rezultat rritjen ekonomike të këtyre komuniteteve.

Një ndër mënyrat që mund të rrisë dinamikën e diversitetin kulturor si dhe të ndihmojë në zhvillimin ekonomik të këtyre komunave është mbështetja dhe zhvillimi i Industrive Kreative. Shembujt tipik të industrive kreative janë punëtoritë artizanale, restorantet apo ndërmarrjet në lidhje me gastronominë, etj. Ndërlidhja e produkteve të Industrive Kreative me përvojat turistike krijon potencial domethënës për zgjerim të numrit të vizitorëve dhe aktiviteteve fitimprurëse nga turizmi. Kjo, më pas, krijon mundësi të reja për zhvillim ekonomik si dhe për mirëmbajtje, promovim e vlerësim më të lartë të kulturës dhe trashëgimisë kulturore.

Këto gjashtë komuna të Kosovës Perëndimore, të cilat janë përfshirë në këtë studim, kanë një potencial të madh për të përfshirë Industrinë Kreative në planet e tyre zhvillimore. Të pasura me bukuri natyrore e asete të trashëgimisë kulturore si dhe me një traditë të shquar në gastronomi e art, këto komuna natyrisht që pjesë të vizionit e kanë zhvillimin ekonomik pjesërisht nëpërmjet turizmit. Promovimi dhe mbështetja e industrive kreative ofron një qasje të re për arritjen e këtij vizioni nga këto gjashtë komuna. Prandaj, projektet si ky, që kanë për qëllim revitalizimin e pjesëve historike e kulturore dhe integrimin e mbështetjen e Industrive Kreative në këtë proces janë tejet të dobishme për të krijuar turizëm e zhvillim të qëndrueshëm, që hap vende pune dhe rrit mirëqenien e banorëve të zonës.

Të pasura me bukuri natyrore e asete të trashëgimisë kulturore si dhe me një traditë të shquar në gastronomi e art, këto komuna natyrisht që pjesë të vizionit e kanë zhvillimin ekonomik pjesërisht nëpërmjet turizmit.

Ky studim është një pjesë e domosdoshme për të matur dhe kuptuar mbarëvajtjen e projekteve të tilla. Pjesë e rëndësishme e studimit ka qenë mbledhja e të dhënave për bizneset që mund të klasifikohen si pjesë e Industrive Kreative si dhe për OJQ-të e palët e tjera të përfshira në zhvillimin e turizmit, kulturës, traditës, artit e sportit në nivelin komunal. Këto të dhëna shërbejnë për të kuptuar më mirë se ku qëndrojnë komunat për sa i përket Industrive Kreative dhe se çfarë potenciali kanë këto të fundit për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të gjashtë komunave të përzgjedhura për këtë studim. Më saktësisht, janë intervistuar 314 biznese në këto 8 kategori si dhe 36 OJQ të fushës, dhe 6 zyrtarë komunal. Pyetëtorët e hartuar enkas për këtë proces kanë pasur pyetje për anën ekonomike (p.sh. numrin e të punësuarve, shpenzimet e të hyrat, etj.) si dhe për gatishmërinë e interesimin e tyre për të marrë pjesë në zhvillimin turistik e kulturor me fokus në Industritë Kreative. Këto pyetje shërbejnë për të ndërtuar indikatorët me të cilët do të matet kontributi i Industrive Ekonomike në ekonominë e komunës në përgjithësi.

Pjesa në vazhdim shpjegon më hollësisht metodologjinë e përdorur për këtë studim. Kapitulli i tretë përmban të gjeturat kryesore të studimit. Përfundimet e studimit janë përshkruar në pjesën e katërt. Në aneks janë vënë pyetëtorët e përdorur.



## Metodologjia

Në këtë pjesë do të shtjellohet metodologjia e përdorur për këtë studim. Fillimisht, për të kuptuar më mirë nevojat e projektit, është ndërmarrë një hulumtim për prapavijën e projektit në përgjithësi, kontekstit lokal dhe Industrinë Kreative në veçanti. Më pas, janë hartuar pyetësorë të veçantë për bizneset, OJQ-të dhe zyrtarët komunal. Këto pyetësorë janë përpiluar me qëllim të nxjerrjes efikase të të dhënave nga këto palë të interesit. Analiza e të dhënave që do të mundësojë hartimin/ndërtimin/ kalkulimin e indikatorëve përkatës.

# 70%

Duke qenë se Peja dhe Gjakova përbëjnë mbi 70 për qind të popullatës së bizneseve që i përkasin Industrive Kreative, mostra për komunitetet më të vogla është mbipopulluar në mënyrë që rezultatet të jenë të krahasueshme në nivelin komunal.

## Hartimi i mostrës të bizneseve

Për të hartuar mostrën e bizneseve që ndërlidhen me Industrinë Kreative është përdorur lista e fundit e bizneseve e publikuar nga Agjencia Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve (AKRB). Fillimisht, lista është pastruar për të përfshirë vetëm bizneset aktive në 6 komunitetet e përfshira në këtë studim. Hapi i dytë ishte filtrimi i bizneseve jo relevante për kategorinë e industrive kreative. Përfundimisht, lista përmblote një popullatë prej 2,659 bizneseve aktive në industrinë kreative në rajonin perëndimor të Kosovës.

Duke u bazuar në madhësinë e popullatës së bizneseve të specifikuar më lartë, madhësia e mostrës adekuate për këtë studim ishte 337 biznese. Kjo mostër na lejon në interval besimi 95 përqind me një marzhë gabimi prej +/- 4 përqind. Shpërndarja e intervistave komunitetet e përfshira sipas kategorive të ndryshme të industrive kreative është bërë duke i ndjekur këto hapa: Në fazën e parë, popullata e bizneseve është stratifikuar në 6 nën-grupe komunale. Duke qenë se Peja dhe Gjakova përbëjnë mbi 70 për qind të popullatës së bizneseve që i përkasin Industrive Kreative, mostra për komunitetet më të vogla është mbipopulluar në mënyrë që rezultatet të jenë të krahasueshme në nivelin komunal. Tabela më poshtë paraqet shpërndarjen e intervistave me biznese në nivelin komunal dhe numrin e intervistave të realizuara. Dallimet në shpërndarje dhe numrin aktual ekzistojnë

për shkak të shuarjes apo mungesës të aktivitetit të bizneseve në disa prej kategorive dhe mungesës së bizneseve adekuate zëvendësuese.

**Tabela 1:** Shpërndarja e mostrës sipas komunave.

Komuna	Numri i intervistave të përcaktuara	Numri i intervistave të realizuara
<b>Gjakovë</b>	98	99
<b>Pejë</b>	91	88
<b>Klinë</b>	52	47
<b>Istog</b>	49	43
<b>Deçan</b>	37	28
<b>Junik</b>	9	9

Në fazën e dytë, bizneset janë grupuar në bazë të aktivitetit të tyre primar. Kjo është bërë me qëllim që rezultatet të paraqesin strukturën sistematike më të gjerë të mundshme të popullatës. Të paktën dy të tretat e bizneseve në Industrinë Kreative i përkasin kategorisë së gastronomisë. Prandaj, për të marrë të dhëna relevante për Industrinë Kreative në tërësi, mostra për kategoritë më të vogla është mbipopulluar. Dallimi në numra të bizneseve të intervistuar në kategoritë e industrive kreative vjen si pasojë e mbylljes të biznesit (dhe jo shuarjes zyrtare në institucionet përkatëse) dhe mungesës së zëvendësimeve adekuate.

Teknika e rëndomizimit është përdorur brenda çdo kategorie për t'u siguruar që mostra e bizneseve të përzgjedhura të pasqyrojë sa më saktë që është e mundur popullatën e bizneseve të industrive kreative. Në fund, lista rezervë është përgatitur për t'u ofruar intervistuesve zëvendësime të bizneseve në rast nevojë gjatë mbledhjes së të dhënave në terren (p.sh. përfaqësuesi i biznesit të përzgjedhur mund të refuzojë të marrë pjesë në studim, biznesi mund të jetë jo-aktiv, etj.). Megjithatë, duke qenë se bizneset në disa kategori të industrive kreative janë në numër shumë të vogël, nuk ka qenë gjith-


Përzgjedhja e OJQ-ve është bërë në mënyrë të rëndomtë nga lista e Ministrisë së Administratës Publike të OJQ-ve të regjistruara në gjashtë komunat e regjionit të Pejës dhe Gjakovës.

monë e mundur të bëhen zëvendësime të përshtatshme. Prandaj, mostra finale e realizuar nuk përkon krejtësisht me mostrën planifikuar. Gjithsesi, rezultatet janë përfaqësuese për komuna dhe Industritë kreative në përgjithësi pasi që dallimet janë të vogla. Për më tepër, aty ku zëvendësimet nuk kanë qenë të mundshme, praktikisht është intervistuar e tërë popullata e bizneseve të asaj kategorie dhe komune.

Pjesa tjetër e studimit ka të bëjë me intervistimin e 36 OJQ-ve. Përzgjedhja e OJQ-ve është bërë në mënyrë të rëndomtë nga lista e Ministrisë së Administratës Publike të OJQ-ve të regjistruara në gjashtë komunat e regjionit të Pejës dhe Gjakovës. Fillimisht, lista është pastruar për të përfshirë vetëm OJQ-të aktive në 6 komunat e përfshira. Hapi tjetër ishte filtrimi i OJQ-ve jo relevante për kategoritë e industrive kreative.

Krahas tyre, janë intervistuar edhe zyrtarët e departamenteve të kulturës, sportit dhe zhvillimit ekonomik të të gjashtë komunave.

Kapitulli në vijim paraqet analizën e të dhënave dhe të gjeturat e studimit.



të gjeturat  
e studimit


## **Ndikimi ekonomik i bizneseve të industrive kreative në komunat perëndimore**

Sipas deklarimeve të bizneseve të intervistuar, të hyrat mesatare të këtyre bizneseve në industritë kreative në regjionin e Dukagjinit për vitin 2017 janë 41,947.66 EUR. Të hyrat e bizneseve nga viti 2015 në 2016 kanë pësuar rritje më të lartë krahasuar me të hyrat e bizneseve nga viti 2016 në vitin 2017. Nga viti 2015 në vitin 2016, të hyrat e bizneseve në industritë kreative janë rritur mesatarisht për 11 përqind, kurse nga viti 2016 në vitin 2017, të hyrat janë rritur mesatarisht për 4 përqind. Tabela e mëposhtme paraqet medianën e të hyrave të bizneseve të intervistuar për vitin 2015, 2016 dhe 2017 të ndara në bazë të komunës. Mediana është vlera e mesit e të hyrave, kur të hyrat radhitën nga vlera më e ultë në vlerën më të lartë. Mediana përdoret si vlerë mesatare në vend të mesatares aritmetike të thjeshtë në rastet kur të dhënat anojnë në një drejtim dhe kur vlera specifike e të dhënave janë dukshëm më të larta se shpërndarja e vlerave të tjera. Meqenëse disa biznese në komuna të ndryshme kanë deklaruar të hyra shumë më të larta, në krahasim me bizneset e komunës së njëjtë, është vendosur të përdoret mediana në vend të mesatares aritmetike të thjeshtë.

Siç shihet nga tabela, komunat me qarkullim më të lartë në industritë kreative gjatë vitit 2017 janë Peja dhe Gjakova. Bizneset në komunën e Deçanit kanë pasur ulje të të hyrave nga viti 2015 në vitin 2017. Bizneset në komunën e Junikut dhe Klinës kanë pësuar ngritje të të hyrave mesatare nga viti 2015 në vitin 2016, mirëpo këto të hyra kanë pësuar një rënie prej vitit 2016 në vitin 2017. Mediana e të hyrave të bizneseve në industritë kreative në komunat e tjera është rritur nga viti 2015 në vitin 2017.

**Tabela 2:** Mediana e të hyrave të bizneseve në industritë kreative sipas komunës 2015, 2016 dhe 2017. Burimi: Anketa me Bizneset në Industritë kreative

Komuna	Të hyrat mesatare të industrive kreative 2015	Të hyrat mesatare të industrive kreative 2016	Të hyrat mesatare të industrive kreative 2017
<b>Deçan</b>	€ 38,076.00	€ 31,922.00	€ 25,000.00
<b>Gjakovë</b>	€ 42,000.00	€ 45,600.00	€ 48,000.00
<b>Junik</b>	€ 32,046.00	€ 32,955.00	€ 29,333.00
<b>Istog</b>	€ 33,903.50	€ 33,328.00	€ 44,825.50
<b>Klinë</b>	€ 34,332.50	€ 43,880.00	€ 42,994.50
<b>Pejë</b>	€ 45,008.00	€ 60,762.50	€ 61,533.00



**Figura 1:** Mediana e të hyrave të bizneseve në industritë kreative sipas komunës 2015, 2016 dhe 2017

Nëse shohim të hyrat e përgjithshme të sektorit privat në secilën prej gjashtë komunave, rezultojnë që industritë kreative kanë pjesëmarrjen më të lartë në ekonominë e Pejës (33.2%). Në komunat tjera, përqindja e pjesëmarrjes së industrive kreative në të hyrat e përgjithshme të bizneseve është nga 9 deri 33 përqind.

**Tabela 3:** Mediana e të hyrave të bizneseve në industrive kreative 2017 e ndarë për komunë

Komuna	Mediana e të hyrave të bizneseve në industritë kreative 2017 <sup>1</sup> (A)	Numri total i bizneseve të industrive kreative <sup>2</sup> (B)	Të hyrat totale të bizneseve të industrive kreative <sup>3</sup> C=(A*B)	Të hyrat e bizneseve <sup>4</sup> (D)	Përqindja (%) e industrive kreative në ekonominë e përgjithshme <sup>5</sup> (C/D)
<b>Deçan</b>	€ 25,000.00	116	€ 2,900,000.00	€ 32,356,262.36	8.96%
<b>Gjakovë</b>	€ 48,000.00	677	€ 32,496,000.00	€ 126,175,721.20	25.75%
<b>Junik</b>	€ 29,333.00	9	€ 263,997.00	€ 2,681,674.50	9.84%
<b>Istog</b>	€ 44,825.50	123	€ 5,513,536.50	€ 27,260,826.29	20.23%
<b>Klinë</b>	€ 42,994.50	127	€ 5,460,301.50	€ 26,833,317.26	20.35%
<b>Pejë</b>	€ 61,533.00	578	€ 35,566,074.00	€ 107,119,514.51	33.20%


1 Burimi: Anкета me Bizneset në industritë kreative

2 Numri i bizneseve në industritë kreative sipas listës së Administratës Tatimore të Kosovës për biznese 2017

3 Shumëzimi i të hyrave mesatare të bizneseve në industritë kreative (nga anketa) me numrin e bizneseve në industritë kreative

4 Burimi: Të dhënat zyrtare të ATK-së për bizneset në Kosovë

5 Pjestimi i të hyrave totale të bizneseve në industritë kreative dhe të hyrat totale të bizneseve




Në përgjithësi bizneset e intervistuar presin një trend pozitiv të rritjes së të hyrave për vitin 2019, krahasuar me vitin 2018, nga shumica e bizneseve. Rreth 73 përqind e bizneseve të intervistuar presin të kenë një rritje të të hyrave në vitin 2019. Këto biznese presin një rritje mesatare prej 15 përqind. Rreth 20 përqind e bizneseve nuk presin ndonjë ndryshim në të hyrat e vitit 2019 krahasuar me ato të vitit 2018, kurse një përqindje më e ultë (6%) presin rënie të të hyrave të tyre.



**Figura 2:** A prisni të keni të hyra më të larta apo më të ulëta në vitin 2019 në krahasim me këtë vit (2018)?

Burimi: Anketa me Bizneset në Industrinë kreative



Sa i përket tatimeve, në bazë të deklarimeve të bizneseve të intervistuar, bizneset tatimpaguese më të mëdha janë në komunën e Gjakovës. Në vitin 2017, mesatarisht bizneset e sektorit të industrive kreative kanë paguar taksa në vlerë prej €3,946. Nuk ka të dhëna mbi tatimin mbi fitim që e paguajnë bizneset në këto komuna.

6 Burimi: Anketa me Bizneset në industrinë kreative

7 Numri i bizneseve në industrinë kreative sipas listës së Administratës Tatimore të Kosovës për biznese 2017

8 Shumëzimi i tatimeve mesatare të bizneseve në industrinë kreative (nga anketa) me numrin e bizneseve në industrinë kreative

**Tabela 4:** Tatimet mesatare të paguara nga bizneset e industrive kreative në vitin 2017 e ndarë për komunë

Komuna	Tatimet mesatare 2017 <sup>6</sup> (A)	Numri total i bizneseve të industrive kreative <sup>7</sup> (B)	Tatimet Totale të Bizneseve të industrive kreative <sup>8</sup> C=(A*B)
<b>Deçan</b>	€ 4,537.12	116	€ 526,305.92
<b>Gjakovë</b>	€ 4,906.60	677	€ 3,321,766.80
<b>Junik</b>	€ 2,860.83	9	€ 25,747.50
<b>Istog</b>	€ 2,990.48	123	€ 367,828.43
<b>Klinë</b>	€ 2,967.05	127	€ 376,809.00
<b>Pejë</b>	€ 3,717.78	578	€ 2,148,879.20

Bizneset e intervistuar në këtë studim janë kryesisht të madhësisë mikro (297) dhe të vogla (17). Këto biznese, gjatë vitit 2017 kanë pasur mesatarisht 3 punëtorë të rregullt me orar të plotë. Nga 314

biznese, 6 prej tyre kanë deklaruar se kanë punësuar mesatarisht 4 punëtorë me gjysmë orari gjatë vitit 2017. Një numër më i madh i bizneseve të intervistuar (36) kanë deklaruar se gjatë vitit 2017 kanë punësuar mesatarisht 5 punëtorë sezonal. Numri më i lartë i të punësuarve në industritë kreative, si përqindje e të punësuarve total në të gjitha industritë brenda komunës, është në komunën e Junikut, Gjakovës dhe Deçanit.


**Tabela 5:** Të punësuarit në industritë kreative krahasuar me numrin total të të punësuarve për komunë për vitin 2017

	Numri total i të punësuarve në industritë kreative <sup>9</sup> (A)	Numri i të punësuarve total <sup>10</sup> (B)	Përqindja (%) e të punësuarve në sektorin e industrive kreative <sup>11</sup> C=A/B
<b>Deçan</b>	696	4,340	16.0%
<b>Gjakovë</b>	2031	13,955	14.6%
<b>Istog</b>	369	5,699	6.5%
<b>Junik</b>	108	536	20.1%
<b>Klinë</b>	381	3,790	10.1%
<b>Pejë</b>	1156	16329	7.1%

9 Numri total i punëtorëve në industritë kreative është llogaritur duke shumëzuar numrin mesatar të punëtorëve në industritë kreative (nga anketa me biznese të industrive kreative) me numrin total të bizneseve në këtë industri për secilën komunë veçmas

10 Të dhëna nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës

11 Pjestimi i numrit total të të punësuarve në industritë kreative me numrin total të të punësuarve në këto komuna



Rroga mesatare e punëtorëve që punojnë në sektorin e industrive kreative me orar të plotë në këto komuna është 277.27 EUR, kurse për punëtorët që punojnë me orar të pjesshëm është 101.7 EUR. Tabela më poshtë paraqet rrogën mesatare për komunat që janë pjesë e këtij studimi.

**Tabela 6:** Paga mesatare për komuna në industritë kreative.  
Burimi: Anketa me Bizneset në industritë kreative

Rroga mesatare e punëtorëve me orar të plotë në industritë kreative		
<b>Deçan</b>	€	344.37
<b>Gjakovë</b>	€	273.37
<b>Junik</b>	€	399.59
<b>Istog</b>	€	239.29
<b>Klinë</b>	€	233.03
<b>Pejë</b>	€	261.34


Në regjionin e Pejës paga mesatare e punëtorëve të industrive kreative është më e ultë (247 EUR) se paga mesatare për të gjitha industritë në rajon (344 EUR). Sa i përket regjionit të Gjakovës, paga mesatare e punëtorëve të industrive kreative (297 EUR) është pothuajse e njëjtë me pagën mesatare për të gjitha industritë në rajon (299 EUR).

**Tabela 7:** Paga mesatare për regjion

	Paga mesatare në industritë kreative <sup>12</sup>	Paga mesatare në regjion <sup>13</sup>
<b>Gjakovë</b>	€297.04	€299
<b>Pejë</b>	€246.91	€344

12 Burimi: Anketa me Bizneset në industritë kreative

13 Burimi: MCC Kosovo: Kosovo Labor Force and Time Use Survey 2017



## **Të dhënat e ndara sipas aktivitetit të biznesit në industrinë kreative**

Bizneset e intervistuar veprojnë në gjashtë kategori të ndryshme të industrive kreative. Nga ndarja e të dhënave në bazë të aktivitetit në të cilin veprojnë bizneset, vërehet se të hyrat më të larta në vitin 2017 kanë qenë për bizneset që operojnë në sektorin e radios dhe TV-së dhe aktivitetëve sportive (të natyrës). Taksat më të larta për vitin 2017 gjithashtu janë paguar nga bizneset që operojnë në po këto aktivitete dhe për eventet kulturore.

Numrin më të lartë mesatar të punëtorëve të rregullt me orar të plotë e kanë raportuar bizneset në gastronomi (4), kurse bizneset në aktivitete sportive (të natyrës) kanë raportuar numrin më të lartë mesatar të punëtorëve të rregullt me gjysmë orari (13) dhe punëtorëve sezonal (8).

Figura 3 paraqet një krahasim të pagave mesatare në mes të bizneseve me aktivitete të ndryshme dhe punëtorëve me orar të plotë dhe gjysmë orari. Siç shihet në figurë, paga mesatare për punëtorët me gjysmë orari është më e ultë se paga mesatare e punëtorëve me orar të plotë. Edhe pse e pritshme të ketë një dallim në mes të këtyre pagave, dallim më i lartë vërehet te bizneset e aktivitetëve të Radios dhe TV-së, ku paga mesatare për punëtorët me orar të plotë është 286 Euro, kurse paga mesatare për punëtorët me gjysmë orari është 50 Euro.


**Tabela 8:** Tabela përmbledhëse me të dhëna të punësimimit sipas aktivitetit të bizneseve. Burimi: Anketa me bizneset në industrinë kreative

	Numri mesatar i punëtorëve të rregullt me orar të plotë	Paga mesatare për punëtorë të rregullt me orar të plotë	Numri mesatar i punëtorëve të rregullt me gjysmë orari	Paga mesatare për punëtorë të rregullt me gjysmë orari	Numri mesatar i punëtorëve sezonal
<b>Aktivite sportive (të natyrës)</b>	3	€ 285.91	13	€ 160.26	8
<b>Dizajn i modës</b>	2	€ 270.83			4
<b>Evente kulturore</b>	2	€ 262.50			
<b>Gastronomi</b>	4	€ 257.50	2	€ 116.67	5
<b>Radio dhe TV</b>	7	€ 286.00	3	€ 50.00	2
<b>Vallëzim dhe produksion tjetër</b>	2	€ 296.32			6



Paga e rregullt për punëtor me orar të plotë

Paga e rregullt për punëtor me gjysmë orari



**Figura 3:** Krahasimi i pagave në mes të aktiviteteve dhe orarit të punëtorëve

Numri mesatar i punëtorëve në këto industri, duke përfshirë punëtorët me orar të plotë, gjysmë orari dhe sezonal, dhe numri total i të punësuarve në këto industri janë të paraqitur në tabelën 9. Kur përfshihen të gjithë punëtorët, bizneset në aktivitetin e Radios dhe TV-së kanë numrin mesatar më të lartë të punëtorëve.

**Tabela 9:** Numri i të punësuarve në industritë kreative

	Numri mesatar i punëtorëve total <sup>14</sup> (A)	Numri total i bizneseve në industritë kreative <sup>15</sup> (B)	Numri total i të punësuarve <sup>16</sup> C=(A*B)
<b>Aktivitete sportive (të natyrës)</b>	3	170	510
<b>Dizajn i modës</b>	3	210	630
<b>Evente kulturore</b>	2	10	20
<b>Gastronomi</b>	4	1042	4168
<b>Radio dhe TV</b>	9	15	135
<b>Vallëzim dhe produksion tjetër</b>	2	145	290


14 Kjo kolonë paraqet numrin mesatar të punëtorëve me orar të plotë, me gjysmë orari dhe sezonal. Burimi: Anketa me bizneset në industritë kreative

15 Numri i bizneseve në industritë kreative sipas listës së Administratës Tatimore të Kosovës për biznese 2017

16 Shumëzimi në mes të numrit mesatar të punëtorëve dhe numrit total të punëtorëve në industritë kreative

### Pjesëmarrja në evente kulturore<sup>3</sup>

Nga të gjitha bizneset e intervistuar, 11 përqind e tyre (33) kanë deklaruar se janë kontraktuar nga komuna për organizim apo pjesëmarrje në evente kulturore në komunën ku ato veprojnë, më shtari në 3 evente kulturore. Rreth 89 përqind e bizneseve kanë deklaruar të kundërtën.



**Figura 4:** A jeni kontraktuar ndonjëherë nga komuna për organizim apo pjesëmarrje në evente kulturore në komunën tuaj?

Rreth 31 përqind e bizneseve që janë kontraktuar nga komuna për evente kulturore kanë pasur rol ekspozimin e produkteve apo shërbimeve të tyre dhe një përqindje e njëjtë kanë deklaruar të kenë qenë sponsor të eventit. Në këto evente bizneset gjithashtu kanë marrë pjesë si ndihmës-organizatorë përmes vullnetarëve (25%), rol argëtues (25%), dhe furnizues të pijeve dhe ushqimit (19%). Role të tjera të përmendura kanë qenë IT dhe përcjellës i eventit.

<sup>3</sup> Burimi i të dhënave për seksionin 2.1.2: Anketa me bizneset në industrinë kreative




**Figura 5:** Cili ka qene roli juaj në këto evente kulturore? (Përgjigje e shumëfishtë)


Rreth 11 përqind (10) e bizneseve që janë kontraktuar nga komuna për evente kulturore kanë deklaruar se kanë punësuar staf enkas për këto evente, mesatarisht 4 persona. Rreth 4 përqind (4) kanë deklaruar se punëtorët sezonal janë punësuar për këtë qëllim dhe 85 përqind (81) kanë mohuar të kenë punësuar staf enkas për këtë qëllim.

**Figura 6:** A keni punësuar njerëz të tjerë enkas (jo pjesë e stafit) për këto evente kulturore?

Në një shkallë prej 1 deri 7, ku 1 do të thotë shumë e rëndësishme, dhe 7 aspak e rëndësishme, bizneset mendojnë se eventet kulturore janë më së shumti të rëndësishme për rritjen ekonomike të komunës dhe më pak të rëndësishme për rritjen e të ardhurave të kompanisë së tyre.








**Figura 7:** Sipas mendimit tuaj sa janë të rëndësishme eventet kulturore për aspektet e mëposhtme?

Sipas 52 përqind të bizneseve të intervistuar, përfituesit kryesorë të këtyre eventeve kulturore janë bizneset, duke pasuar nga banorët e komunës (25%) dhe komuna (15%).



**Figura 8:** Sipas mendimit tuaj, kush janë përfituesit kryesorë të këtyre eventeve.



## Roli i OJQ-ve në industritë kreative në komnatat perëndimore

Kjo pjesë e raportit prezanton të gjeturat nga anketimi i OJQ-ve që veprojnë në industritë kreative në regjionin perëndimor të Kosovës. Rezultatet e studimit tregojnë që OJQ-të në këto regjione kanë rritje në numër të punëtorëve të pjesshëm nga viti 2017 në vitin 2018, nga mesatarisht 2.8 punëtorë në vitin 2017 në 4.5 punëtorë në vitin 2018. Sa i përket numrit të punëtorëve me orar të plotë, nuk ka ndonjë ndryshim domethënës (2.9 në 2017; 3.0 në 2018). Organizatat jo-qeveritare që janë intervistuar kanë deklaruar që numri i punëtorëve me orar të plotë që janë të përfshirë në projekte brenda industrive kreative është 1.5, që përbën 5 përqind të të gjithë punëtorëve me orar të plotë. Në anën tjetër, numri i punëtorëve me orar të pjesshëm që janë të përfshirë në projekte brenda industrive kreative (79%) është dukshëm më i lartë në proporcion me numrin e punëtorëve që përfshihen në projekte tjera (29%).



Personat e përfshirë në projekte brenda industrisë kreative




Punëtorët tjerë

**Figura 9:** Ju lutem na tregoni sa persona keni punësuar në OJQ-në tuaj gjatë vitit 2017 dhe 2018?

Paga mesatare mujore (bruto) e të punësuarve të përfshirë në projekte brenda industrive kreative është raportuar të jetë 292.5 Euro në vitin 2017 dhe 327.6 Euro në vitin 2018, që përbën rritje mesatare të pagës prej 12 përqind. Paga mesatare e raportuar nga OJQ-të për vitin 2018 është dukshëm nën pagën mesatare në Kosovë, që sipas Agjencionit të Statistikave të Kosovës në vitin 2017 ishte 528 Euro.<sup>4</sup>

<sup>4</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Niveli i pagave në Kosovë 2012-2017 (Tetor 2018)



Paga mesatare për personat e përfshirë në projekte brenda industrisë kreative

292.5€



2017

327.6€



2018

**Figura 10:** Paga mesatare mujore

Kur janë pyetur rreth eventeve kulturore që organizohen në komunitat e tyre, shumica e madhe e OJQ-ve (86%) kanë deklaruar se kanë qenë të përfshira në to.

**Figura 11:** A keni organizuar ose marrë pjesë ndonjëherë në evente kulturore në komunën tuaj?

Në shumicën e rasteve, roli i këtyre OJQ-ve në këto evente kulturore ka qenë si ndihmës-organizatorë përmes vullnetarëve (60%) apo si pjesëmarrës në ekspozimin e produkteve apo shërbi-meve (60%).

PO  
86%



JO  
14%



**Figura 12:** Cili ka qenë roli juaj në këto evente kulturore?

Më shumë se gjysma e OJQ-ve që përfshihen në evente kulturore (52%) kanë angazhuar punëtorë shtesë enkas për këto evente.

**Figura 13:** A keni punësuar punëtorë të tjerë enkas për këto evente kulturore?

Në përgjithësi, OJQ-të e intervistuar janë të mendimit që eventet kulturore që organizohen në komunat e tyre bëjnë promovimin e kulturës për turizëm (83%), shpijnë në rritjen e vizitorëve (83%), shtojnë interesimin e njerëzve për kulturë (79%), dhe ndikojnë në reputacionin e komunës për turizëm (79%). Për më tepër, më shumë se gjysma e OJQ-ve deklaruan se eventet kulturore ndikojnë edhe në rritjen ekonomike të komunës (52%), ndërsa 41 përqind e tyre thanë që ato ndikojnë në rritjen e të ardhurave.






**Figura 14:** Sipas mendimit tuaj sa janë të rëndësishme eventet kulturore për aspektet e mëposhtme?


Pothuajse tri në çdo katër OJQ-të anketuara (74%) janë të mendimit që banorët e komunës janë ndër përfituesit kryesor të eventeve kulturore. Për më tepër, 63 përqind e OJQ-ve besojnë që edhe bizneset përfitojnë nga këto evente, ndërsa 37 përqind e tyre janë të mendimit që komuna dhe/ose OJQ-të janë ndër përfituesit kryesor.

**Figura 15:** Sipas mendimit tuaj, kush janë përfituesit kryesorë të këtyre eventeve?



## Analizë krahasuese në mes të OJQ-ve dhe bizneseve në industritë kreative

Rezultatet e studimit tregojnë se paga mesatare mujore në industritë kreative është më e lartë në sektorin e shoqërisë civile (327.6 Euro) se sa në sektorin privat (277.3 Euro).




**Figura 16:** Krahasimi i pagave mesatare të punëtorëve në industritë kreative në mes të OJQ-ve dhe bizneseve

Megjithatë, një biznes që vepron në industritë kreative ka pasur mesatarisht 3 punëtorë me orar të plotë gjatë vitit 2017, në krahasim me OJQ-të që realizojnë projekte në industritë kreative të cilat kanë pasur mesatarisht 1.4 punëtorë me orar të plotë të involvuar në projekte relevante gjatë të njëjtit vit. Siç edhe është raportuar më lartë, numri mesatar i punëtorëve me orar të plotë ka lëvizur në 1.5 tek OJQ-të për vitin 2018, që është sa gjysma e numrit mesatar të punëtorëve të raportuar nga bizneset. Situata është e ngjashme edhe sa i përket numrit të punëtorëve me orar të pjesshëm, ku bizneset (4) gjatë vitit 2017 kanë pasur mesatarisht dyfish më shumë punëtorë me orar të pjesshëm se sa OJQ-të (2).

Përkundër numrit më të lartë të punëtorëve në biznese, janë OJQ-të ato që në përqindje më të lartë (48.5%) angazhojnë punëtorë shtesë enkas për aktivitete kulturore, në krahasim me 14.7 përqind të bizneseve.

Për më tepër, OJQ-të kanë më shumë gjasa të angazhohen në forma të ndryshme në aktivitete kulturore se sa bizneset. Siç edhe shihet në grafikun e mëposhtëm, 60 përqind e OJQ-ve janë bashkë-organizatorë në aktivitete kulturore dhe në përqindje të njejtë (60%) janë pjesëmarrës në ekspozim të produkteve/ shërbimeve. Në anën tjetër, vetëm çdo i katërti biznes i involvuar në aktivitete kulturore merr pjesë si bashkë-organizator dhe 31 përqind e tyre ekspozojnë produktet apo shërbimet në këto evente.



**Figura 17:** Rolet e OJQ-ve dhe bizneseve në evente kulturore


Si bizneset ashtu edhe OJQ-të besojnë që aktivitetet kulturore janë konsiderueshëm të rëndësishme në rritjen e punësimit (5.1 – bizneset, 5.2 – OJQ-të) dhe rritjen ekonomike të komunës (5.1 – bizneset, 5.2 – OJQ-të).



**Figura 18:** Krahasimi në mes OJQ-ve dhe bizneseve: Sipas mendimit tuaj sa janë të rëndësishme eventet kulturore për aspektet e mëposhtme? [1 = aspak të rëndësishme; 7 = shumë të rëndësishme]

Edhe komuniteti i bizneseve edhe ai i shoqërisë civile janë të mendimit që bizneset janë ndër përfituesit kryesorë të eventeve kulturore që organizohen në komunat e tyre. Organizatat jo-qeveritare kanë më shumë gjasa që të ndajnë mendimin që vetë banorët e komunave të tyre janë përfituesit kryesor të organizimit të aktiviteteve kulturore.

**Figura 19:** Krahasimi në mes të OJQ-ve dhe bizneseve: Sipas mendimit tuaj, kush janë përfituesit kryesorë të këtyre eventeve?






## Roli i komunave në industritë kreative në rajonin perëndimor

Në këtë pjesë të studimit do të paraqiten të dhënat e marra nga zyrtarët komunal të drejtorivetë kulturës, rinisë dhe sportit dhe atyre të zhvillimit ekonomik.

Në figurën 14 mund të shihet se komuna e Pejës ka stafin më të madh në drejtorinë e kulturës, rinisë dhe sportit, 47 në vitin 2017 dhe 46 në vitin 2018. Komuna e Junikut ka pasur vetëm 4 të punësuar si në vitin 2017, po ashtu edhe në vitin 2018 në sektorin e kulturës, rinisë dhe sportit.\* Këto rezultate përkrijnë dhe me madhësinë e këtyre komunave.


\* Sektorit i Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Junikut funksionon së bashku me atë të Arsimit në një drejtori.




**Figura 20:** Ju lutem na tregoni sa punëtorë janë të punësuar në departamentin e kulturës, rinisë dhe sportit?

Zyrtarët komunal më pas janë pyetur për rëndësinë që kanë eventet kulturore për komunën në aspekte të ndryshme ku numri 1 nënkupton rëndësi të madhe ndërsa numri 7 nënkupton aspak rëndësi. Eventet kulturore shihen si shumë të rëndësishme në të gjitha komunat e përfshira për sa i përket reputacionit të komunës për turizëm si dhe për promovimin e kulturës për të njëjtin qëllim. Komuna e Klinës vlerëson se eventet kulturore janë pak të rëndësishme për rritjen e punësimit në komunë. Komuna e Junikut ka të njëjtin mendim për sa i përket rritjes ekonomike të komunës.

Komuna që ka organizuar apo marrë pjesë në më së shumti ngjarje kulturore ka qenë ajo e Pejës në vitin 2018 me rreth 30 aktivitete. Pas saj vjen Gjakova me 27 aktivitete të organizuara për vitin 2018. Komuna që ka organizuar më së paku ngjarje është ajo e Istogut, me 7 aktivitete në vitin 2018.




**Figura 21:** Sipas mendimit tuaj sa janë të rëndësishme eventet kulturore për aspektet e mëposhtme? (Ne shkallë nga 1 deri në 7, ku 1 nënkupton shumë e rëndësishme dhe 7 aspak e rëndësishme, 888 Nuk e di dhe 999 Refuzoj)



**Figura 22:** Sa ngjarje kulturore ka organizuar ose ka marrë pjesë komuna në vitin 2018?

Edhe pse kanë organizuar një numër të përafërt aktivitete, komuna e Pejës ka pasur më shumë vizitorë për vitin 2018 në krahasim me komunën e Gjakovës, siç shihet në figurën 22 dhe 23.

Në vend të tretë vjen Deçani me 14,400 vizitorë për aktivitetet e organizuara nga komuna, ndërsa Klinë ka pasur më së pakti vizitorë në 2018, vetëm 1770. Sipas deklarimeve të Komunave, komuna e Pejës qëndron si më aktivja për sa i përket organizimeve dhe pjesëmarrjes në ngjarje kulturore. Me mesatare të pjesëmarrjes për aktivitet Peja pasohet nga komuna e Deçanit përkundër numrit dukshëm më të vogël të popullatës në këtë komunë.



**Figura 23:** Sa vizitorë kanë vizituar komunën në vitin 2018 gjatë këtyre ngjarjeve kulturore?

Të dhënat e prezantuara më lartë paraqesin numrin e vizitorëve/pjesëmarrësve në ngjarjet e organizuara nga komuna. Këto shifra janë të vetëraportuara nga zëdhënësit komunal. Pjesëmarrësit në evente mund të jenë vetë banorë të komunës, banorë të komunave të tjera

apo edhe vizitorë të jashtëm. Është gjithashtu e rëndësishme të shikohet se sa vizitorë kanë këto vende në përgjithësi dhe jo vetëm në eventet e organizuara nga komunat. Këto të dhëna janë marrë nga raporti i ASK-së mbi Statistikat e Hotelerisë, i cili shfrytëzon anketën e Hotelerisë, anketën e Turizmit “Pushimet dhe Udhëtimet” dhe anketën “Qarkullimi turistik në pikë kalimet kufitare” nga Policia e Kosovës.

Tabela 10 më poshtë tregon numrin e vizitorëve vendorë dhe të jashtëm në regjionin e Gjakovës dhe atë të Pejës për periudhën 2017 dhe 2018. Vizitor vendor është një person me vendbanim të përherëshëm në Kosovë, por i cili qëndron për së paku një natë në një vend tjetër në Kosovë. Vizitor i jashtëm konsiderohet një person me vendbanim të përherëshëm jashtë Kosovës, por i cili qëndron përkohësisht në Kosovë për së paku një natë. Bazuar në këto të dhëna, regjioni i Pejës është dukshëm më atraktiv si për vizitorët vendorë po ashtu dhe për ata të jashtëm. Regjioni i Gjakovës radhitet i katërti nga shtatë regjionet e Kosovës për sa i përket numrit të vizitorëve, ndërsa ai i Pejës është në vend të dytë pas regjionit të Prishtinës.

**Tabela 10:** Numri i vizitorëve në regjionin e Pejës dhe Gjakovës (2017-2018)


	Vizitorë vendorë dhe të jashtëm	
	2017	2018
<b>Gjakovë</b>	13560	14521
<b>Pejë</b>	57312	75151

Burimi: Statistikat e Hotelerisë TM4 2018 (ASK)

Komuna e Deçanit mendon se përfituesit kryesorë të këtyre ngjarjeve janë bizneset, OJQ-të, banorët e komunës, komuna, dhe të gjitha grupet e tjera kulturore të cilat janë pjesëmarrës në organizime. Për komunën e Istogut dhe atë të Gjakovës, vetëm banorët shihen si përfitues kryesor të këtyre organizimeve kulturore. Përveç banorëve, edhe OJQ-të bëjnë pjesë të përfituesve të rëndësishëm sipas komunës së Junikut. Për komunën e Klinës, bizneset, OJQ-të, banorët e komunës si dhe vetë komuna janë përfituesit kryesorë të këtyre eventeve. Në fund, sipas komunës së Pejës, këto evente kryesisht janë të vlefshme për bizneset dhe vetë komunën.

Qendrat për informata turistike janë të domosdoshme për zhvillimin e turizmit lokal. Ato shërbejnë si pikë orientimi për vizitorët si dhe ndihmojnë në informimin e pasurimin e eksperiencës së tyre përgjatë vizitës në komunë. Vendndodhja, orari i hapjes, si dhe shërbimi brenda këtyre qendrave luan rol të rëndësishëm për turizmin lokal. Komuna e Istogut dhe Klinës nuk kanë qendra për informata turistike. Komuna e Pejës dhe Deçanit kanë nga një qendër secila dhe punësojnë 3 dhe 2 persona respektivisht. Për dallim nga komunat e lartpërmendura, ajo e Junikut dhe e Gjakovës kanë nga dy qendra për informata turistike që punësojnë 8 persona në total (6 në Junik e 2 në Gjakovë). Qendra për informata turistike në Pejë, Junik dhe Gjakovë punojnë 8 orë në ditë dhe nuk punojnë gjatë fundjavës. Komuna e Deçanit e mban të hapur edhe në fundjavë qendrën e saj për informata turistike. Në këtë qendër, orari i punës është 8 orë gjatë javës, ndërsa në fundjavë 12 orë.







përfundime

**Industritë Kreative janë një ndër** elementet kryesore në planet zhvillimore ekonomike ku turizmi lokal luan rol kyç. Rajoni i Dukagjinit njihet si vend me traditë dhe ka shumë për të ofruar në anën e turizmit. Andaj, zhvillimi ekonomik në këtë pjesë të Kosovës natyrisht se ndërlihet ngushtë me turizmin lokal. Për këtë arsye ky studim ka pasur për qëllim të matë kontributin e industrive kreative në zhvillimin ekonomik rajonal në gjashtë komunat e Kosovës Perëndimore (Deçan, Gjakovë, Istog, Junik, Klinë dhe Pejë).

Më specifikisht, objektivat e këtij studimi ishin të krahasojë të hyrat e bizneseve të këtij sektori me të hyrat e të gjitha bizneseve që operojnë në këto komuna, të ofrojë informata mbi numrin e të punësuarve dhe pagën mesatare të kësaj industrie, të analizojë të dhënat në bazë të aktiviteteve të bizneseve pjesëmarrëse në studim dhe kontributin e këtij sektori në zhvillimin kulturor të këtyre komunave.

Sipas të gjeturave të këtij studimi, bizneset në industritë kreative në rajonin e Dukagjinit mund të jenë mundësi e volitshme investimi pasi që të hyrat e tyre kanë pësuar rritje në përgjithësi nga viti 2015. Mediana e të hyrave vjetore të bizneseve të kësaj industrie varion nga €25,000 në komunën e Deçanit te €61,500 në komunën e Pejës. Për më tepër, pronarët e bizneseve janë gjithashtu optimist për të ardhmen; shumica e tyre presin rritje të të hyrave për vitin 2019.

Bizneset e kësaj industrie punësojnë mesatarisht 3 punëtorë të rregullt me orar të plotë, një numër i konsiderueshëm duke u nisur nga fakti se shumica drastike e bizneseve në Kosovë janë mikro ose të vogla. Në total, të punësuarit e kësaj industrie paraqesin 10 përqind të të punësuarve në tërësi në këto gjashtë komuna. Megjithatë, paga mesatare e punëtorëve të rregullt me orar të plotë në industritë kreative në këto komuna është 277 EUR, një rrogë jo shumë e lartë në krahasim me rrogën mesatare në Kosovë.

Mediana e të hyrave vjetore të bizneseve të kësaj industrie varion nga €25,000 në komunën e Deçanit te €61,500 në komunën e Pejës.

Edhe pse këto biznese i përkasin industrive kreative, vetëm një pjesë e vogël e tyre janë kontraktuar nga komuna për organizim apo pjesëmarrje në evente kulturore. Ka ende hapësirë dhe punë për t'u bërë në angazhimin dhe përfshirjen e bizneseve në këtë fushë.


Ky studim gjithashtu ka ardhur në përfundim se industritë kreative kanë përfituar edhe nga përfshirja e OJQ-ve në regjionin e Pejës dhe atë të Gjakovës. Ata punësojnë mesatarisht më shumë se një punëtor që ka një pagë mujore më të lartë se ata në sektorin privat, mesatarisht 328 EUR. OJQ-të janë më të përfshira nga komuna se bizneset për organizim apo pjesëmarrje në evente kulturore dhe në pjesë më e madhe e tyre punësojnë persona enkas për këto raste. Edhe pse duket se OJQ-të janë të përfshira në zhvillimin e industrive kreative, një bashkëpunim më i fortë në mes të tyre dhe bizneseve në veçanti do të ndihmonte edhe më tutje zhvillimin e këtij sektori.

Në fund, komunat të cilat luajnë rolin kryesor në planifikimin e zhvillimit ekonomik lokal, ndajnë mendimin se eventet kulturore janë shumë të rëndësishme për turizëm e për promovimin e kulturës. Ato organizojnë një sërë aktiviteteve kulturore e sportive si dhe parashohin shpenzime kapitale për zhvillimin e turizmit lokal në të ardhmen.

Komuna e Pejës ka numrin më të lartë të pjesëmarrësve për ngjarjet kulturore, ndërsa ajo e Klinës ka numrin më të ultë të pjesëmarrësve për këto raste. Regjioni i Pejës është regjioni i dytë më i vizituar në Kosovës pas regjionit të Prishtinës. Regjioni i Gjakovës është dukshëm më mbrapa regjionit të Pejës për sa i përket numrit të vizitorëve të jashtëm dhe vendorë si për vitin 2017 dhe për 2018. Mirëpo, sa i përket bashkëpunimit të komunave me bizneset dhe OJQ-të ka hapësirë të dukshme për përmirësime të gjitha komunat të cilat janë pjesë e këtij studimi.

Si përfundim, kultura, natyra dhe në përgjithësi turizmi lokal duket të jetë një faktor jo pak i rëndësishëm për këtë rajon si në anën afariste, po ashtu edhe në anën e planeve të institucioneve publike. Mirëpo, duhet ende të punohet nga komunat për përfshirjen më të madhe dhe mbështetjen e bizneseve në këtë fushë si dhe bashkëpunim më të fortë në mes këtyre të fundit dhe OJQ-ve.





aneks: pyetësorët e  
përdorur për anketa

## PYETËSORI PËR BIZNESE

### Pyetjet demografike

1. **Numri identifikues i biznesit:** \_\_\_\_\_
2. **Emri i biznesit:**  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
3. **Aktiviteti i biznesit**
  1. Aktivitete sportive (të natyrës)
  2. Dizajn i modës
  3. Evente kulturore
  4. Galeri
  5. Gastronomi
  6. Kinema
  7. Radio dhe TV
  8. Vallëzim dhe produksion tjetër
4. **Komuna**
  1. Deçan
  2. Gjakovë
  3. Istog
  4. Junik
  5. Klinë
  6. Pejë
5. **Vendbanimi:**
  1. Rural
  2. Urban
6. **Gjinia e respondentit (Intervistuesi: Mos pyet, kodo)**
  1. Mashkull
  2. Femër
  3. Tjetër
7. **Cila është pozita juaj brenda kësaj kompanie?**
  1. Menaxher ekzekutiv
  2. Zyrtar i lartë i financave
  3. Pronar (biznes i vogël)
  4. Bashkë-pronar
  5. Tjetër (specifiko) \_\_\_\_\_
8. **Cili është statusi i pronësisë së kompanisë tuaj?**
  1. Privat kosovar
  2. Sipërmarrje e përbashkët, me pjesëmarrje të huaj
  3. 100% e huaj
  4. Tjetër (Specifiko) \_\_\_\_\_



**9. Sa është madhësia e kompanisë tuaj?**

1. Mikro (Më pak se 10 persona)
2. E vogël (10-49 persona)
3. Mesatare (50-249 persona)
4. E madhe (250+ persona)

**10. Në cilin vit ka filluar punën biznesi juaj?** \_\_\_\_\_

**Pyetjet ekonomike**

**11. Ju lutem na tregoni sa punëtorë i ka kompania juaj:**

1. Punëtorë të rregullt me orar të plotë: \_\_\_\_\_
2. Punëtorë të rregullt me gjysmë orari: \_\_\_\_\_
3. Punëtorë sezonal: \_\_\_\_\_

**12. Ju lutem na tregoni sa kanë qenë të hyrat dhe shpenzimet e kompanisë tuaj në 3 (tre) vitet e fundit?**

2015		2016		2017	
Të hyrat (qarkullimi)	Shpenzimet	Të hyrat (qarkullimi)	Shpenzimet	Të hyrat (qarkullimi)	Shpenzimet

**13. Sa ka shpenzuar përafërsisht kompania juaj në vitin 2017 në paga të punëtorëve?**

1. Për punëtorë të rregullt me orar të plotë: \_\_\_\_\_ (Euro)
2. Për punëtorë të rregullt me gjysmë orari: \_\_\_\_\_ (Euro)
3. Për punëtorë sezonal: \_\_\_\_\_ (Euro)

**14. Ju lutem na tregoni përafërsisht shumën që keni paguar në tatim të kompanisë (TAK) në vitin e fundit (2017)?**

\_\_\_\_\_ EUR

**15. Ju lutem na tregoni sa mendoni/pritni se do të jenë të hyrat dhe shpenzimet e kompanisë tuaj përafërsisht këtë vit (2018)?**

14.1. Të hyrat (qarkullimi): \_\_\_\_\_ EUR

14.2. Shpenzimet: \_\_\_\_\_ EUR

**17.A prisni të keni të hyra më të larta apo më të ulëta në vitin 2019 në krahasim me këtë vit (2018)?**

1. Rritje: \_\_\_ %
2. Rënie: \_\_\_ %
3. Nuk pres ndonjë ndryshim

**17.A jeni kontraktuar ndonjëherë nga komuna për organizim apo pjesëmarrje në evente kulturore në komunën tuaj?**

1. Po, në sa prej tyre

\_\_\_\_\_

2. Jo (Kalo te P19)

**18.Cili ka qene roli juaj në këto evente kulturore? (Përgjigje e shumëfishtë)**

1. Sponzor i eventit
2. Pjesëmarrës në ekspozimin e produkteve apo shërbimeve
3. Transport
4. Argëtim
5. Ndihmës-organizatorë permes vullnetareve
6. Akomodim
7. Sport
8. Ushqim dhe pije
9. Tjetër, të lutem specifikojë \_\_\_\_\_

**19.A keni punësuar njerëz të tjerë enkas (jo pjesë e stafit) për këto evente kulturore?**

1. Po, sa

\_\_\_\_\_

2. Jo

3. Punëtorët sezonal janë punësuar për këtë qëllim

**20.Sipas mendimit tuaj sa janë të rëndësishme eventet kulturore për aspektet e mëposhtme? (Ne shkallë nga 1 deri në 7, ku 1 nënkupton shumë e rëndësishme dhe 7 aspak e rëndësishme, 888 Nuk e di dhe 999 Refuzoj)**

19.1.Rritjen e punësimit në komunën tuaj	1	2	3	4	5	6	7	888	999
19.2. Rritjen e të ardhurave të kompanisë tuaj	1	2	3	4	5	6	7	888	999
19.3. Rritjen ekonomike të komunës	1	2	3	4	5	6	7	888	999

**21.Sipas mendimit tuaj, kush janë përfituesit kryesorë të këtyre eventeve?**

1. Bizneset
  2. OJQ
  3. Banorët e komunës
  4. Komuna
  5. Tjetër, të lutem specifikojë
- 

### **Informata mbi anketën**

**Emri** \_\_\_\_\_ **dhe** \_\_\_\_\_ **mbiemri** \_\_\_\_\_ **i** \_\_\_\_\_ **të**  
**intervistuarit:** \_\_\_\_\_

**Numri kontaktues i të**  
**intervistuarit:** \_\_\_\_\_

**Emri i anketuesit/es:**  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**Intervista u realizua në: Datën**  
\_\_\_\_\_

**Intervista ka zgjatur:** \_\_\_\_\_ (Minuta)

### PYETËSORI PËR OJQ

#### **Pyetjet Demografike**

- 1. Emri i Organizatës Joqeveritare (OJQ-së):**  
\_\_\_\_\_
- 2. Komuna:**
  1. Deçan
  2. Gjakovë
  3. Istog
  4. Junik
  5. Klinë
  6. Pejë
- 3. Gjinia e respondentit (Intervistuesi: Mos pyet, kodo)**
  1. Mashkull
  2. Femër
  3. Tjetër
- 4. Cila është pozita juaj brenda kësaj OJQ-je?**
  1. Drejtor/eshë
  2. Menaxher/e i/e projekteve
  3. Zyrtar/e i/e projekteve
  4. Tjetër, të lutem specifikojë

---

5. Në cilin vit është themeluar OJQ-ja juaj? \_\_\_\_\_

**Pyetjet ekonomike**

6. Ju lutem na tregoni sa persona keni punësuar në OJQ-në tuaj gjatë vitit 2017 dhe 2018:

	2017		2018	
	<i>Gjithsej</i>	<i>Vetëm për personat e përfshirë në projekte brenda industrive kreative (kulturë, sport, art, gastronomi, etj.)</i>	<i>Gjithsej</i>	<i>Vetëm për personat e përfshirë në projekte brenda industrive kreative (kulturë, sport, art, gastronomi, etj.)</i>
Persona të rregullt me orar të plotë				
Persona të rregullt me gjysmë orari				

7. Sa ka shpenzuar përafërsisht OJQ-ja juaj në vitin 2017 dhe 2018 në paga?

	2017		2018	
	<i>Gjithsej</i>	<i>Vetëm për personat e përfshirë në projekte brenda industrive kreative (kulturë, sport, art, gastronomi, etj.)</i>	<i>Gjithsej</i>	<i>Vetëm për personat e përfshirë në projekte brenda industrive kreative (kulturë, sport, art, gastronomi, etj.)</i>
Paga bruto (Euro)				

8. A keni organizuar ose marrë pjesë ndonjëherë në evente kulturore në komunën tuaj?

- Po, në sa prej tyre

\_\_\_\_\_

- Jo (Kalo te P13)

**9. Cili ka qenë roli juaj në këto evente kulturore? (Përgjigje e shumëfishtë)**

- Sponzor i eventit
- Pjesëmarrës në ekspozimin e produkteve apo shërbimeve
- Transport
- Argëtim
- Ndihmës-organizatorë permes vullnetareve
- Akomodim
- Sport
- Ushqim dhe pije
- Tjetër, të lutem specifikojë \_\_\_\_\_

**10.A keni punësuar punëtorë të tjerë enkas (jo pjesë e stafit të OJQ-së) për këto evente kulturore?**

- Po, sa

\_\_\_\_\_

- Jo (Kalo te P12)

**11.Përafërsisht sa i keni paguar për ditë të punësuarit enkas për evente?**

\_\_\_\_\_ Euro

**12.Sa vizitorë, mesatarisht për ditë, kanë vizituar eventet kulturore që ju keni organizuar/marrë pjesë në vitin 2018?**

Eventi kulturor	Numri i vizitorëve
Steel Wings Choper	
Reel Rock Tour	
Panairi "Ditet e Mjaltit"	
Reel Rock Tour Marimangat	
Into the Park	
Anibar	
Hecje deri te Maja e Hajles	
Hecje deri te Guri I kuq	
Hecje deri te maja e Kopranikut	
Hecje deri te maja e Volljakes	
Hiking tre Maje	
4x4 Rides in Rugova	

Rafting ne Gryke te Rugoves	
Paraglajding-Maja e Zeze	
Shtegu nderkombetar Majat e Ballkanit	
Shtegu nderkufitar Via Dinarica	
Zip line marimangat	
Via Ferrata Mat	
Via Ferrata Ari	

**12.1. Nëse keni organizuar apo marrë pjesë në evente kulturore të cilat nuk janë përmendur më lartë, ju lutem na tregoni emrin përkatës dhe numrin e vizitorëve:**

Eventi kulturor	Numri i vizitorëve

**13. Sipas mendimit tuaj sa janë të rëndësishme eventet kulturore për aspektet e mëposhtme? (Ne shkallë nga 1 deri në 7, ku 1 nënkupton shumë e rëndësishme dhe 7 aspak e rëndësishme, 888 Nuk e di dhe 999 Refuzoj)**

Aspektet	1 nënkupton shumë e rëndësishme dhe 7 aspak e rëndësishme, 888 Nuk e di dhe 999 Refuzoj									
	1	2	3	4	5	6	7	888	999	
Rritjen e punësimit										
Rritjen e të ardhurave										
Rritjen e vizitorëve										
Promovimin e kulturës për turizëm										
Reputacionin e komunës për turizëm										

Interesimin e personave për kulturë	1	2	3	4	5	6	7	888	999
Rritjen ekonomike të komunës	1	2	3	4	5	6	7	888	999

**14. Sipas mendimit tuaj, kush janë përfituesit kryesorë të këtyre eventeve?**

1. Bizneset
2. OJQ
3. Banorët e komunës
4. Komuna
5. Tjetër, të lutem specifikojë \_\_\_\_\_

**Informata mbi anketën**

**Emri dhe mbiemri i të**

**intervistuarit:** \_\_\_\_\_

**Numri kontaktues i të**

**intervistuarit:** \_\_\_\_\_

**PYETËSORI PËR KOMUNA**

**1. Ju lutem na tregoni sa punëtorë janë të punësuar në departamentin e kulturës, rinisë dhe sportit?**

1.1 Në vitin 2017:

\_\_\_\_\_

1.2 Në vitin 2018:

\_\_\_\_\_

**2. Sipas mendimit tuaj sa janë të rëndësishme eventet kulturore për aspektet e mëposhtme? (Ne shkallë nga 1 deri në 7, ku 1 nënkupton shumë e rëndësishme dhe 7 aspak e rëndësishme, 888 Nuk e di dhe 999 Refuzoj)**

Aspektet	1 nënkupton shumë e rëndësishme dhe 7 aspak e rëndësishme, 888 Nuk e di dhe 999 Refuzoj								
Rritjen e punësimit	1	2	3	4	5	6	7	888	999
Rritjen e të ardhurave	1	2	3	4	5	6	7	888	999

Rritjen e vizitorëve	1	2	3	4	5	6	7	888	999
Promovimin e kulturës për turizëm	1	2	3	4	5	6	7	888	999
Reputacionin e komunës për turizëm	1	2	3	4	5	6	7	888	999
Interesimin e personave për kulturë	1	2	3	4	5	6	7	888	999
Rritjen ekonomike të komunës	1	2	3	4	5	6	7	888	999

### 3. Sa evente kulturore ka organizuar ose ka marrë pjesë komuna:

3.1. Gjatë vitit 2017

---

3.2. Gjatë vitit 2018

---

### 4. Sa vizitorë, mesatarisht për ditë, kanë vizituar komunën në vitin 2018 gjatë këtyre eventeve kulturore?

Eventi	Numri i vizitorëve
Kultura Pejane ndër vite	
Ditet e Diaspores	
Kolonia e artit	
Flaka e Janarit	
Dita Ndërkombëtare e Muzeve	
Ekspozita "Trashëgimia Kulturore Arkeologjike"	
Aktiviteti i Amsambllit Rugova	
Peja International Guitar Festival	
Zgjedhja e Sportistit të Vitit	
Manifestimi "Ditët e Jusuf Gërvallës"	
17 shkurti Dita e Pavarsisë së Kosovës	
Festa e 28 nëntorit	
Dita e çlirimit të qytetit të Pejës	
Dita e Tokës	
Lojrat Tradicionale të Rugovës	



Shqip Film Fest	
PANAIRI TURISTIK TRADICIONAL "QËNDRO PËR FUNDJAVË - PËRJETO PEJËN	
Festivali I këngës për fëmijë "HAREJA"	
Festivali I vallëzimit "HAREJA"	
Shtegu Kulturor Peje	

**4.1. Nëse keni organizuar apo marrë pjesë në evente kulturore të cilat nuk janë përmendur më lartë, ju lutem na tregoni emrin përkatës dhe numrin e vizitorëve:**

Eventi kulturor	Numri i vizitorëve

**5. A prisni që numri i vizitorëve për vitin e ardhshëm?**

1. Rritet me \_\_\_ %
2. Mbetet i njëjtë
3. Zvogëlohet me \_\_\_ %
4. Nuk e di

**6. Sipas mendimit tuaj, kush janë përfituesit kryesorë të këtyre eventeve?**

1. Bizneset
2. OJQ
3. Banorët e komunës
4. Komuna
5. Tjetër, të lutem specifikojë \_\_\_\_\_

**7. A ka qendër për informata turistike në komunën tuaj?**

1. Po, sa \_\_\_\_\_
2. Jo (Kalo te 'Informatat mbi anketën')

**8. Sa punëtorë punojnë në këtë qendra informative?**

**9. Sa ditë në javë punojnë?** \_\_\_\_\_

**10.A punojnë gjatë fundjavës?**

1. Po
2. Jo

11. Sa orë në ditë  
punojnë?

\_\_\_\_\_

**Informata mbi anketën**

**Emri dhe mbiemri i të intervistuarit:**

\_\_\_\_\_

**Numri kontaktues i të intervistuarit:**

\_\_\_\_\_







